



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVO			
MINISTRIA E PUNEVE TE JASHTME DHE DIASPORES MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS AND DIASPORA			
MINISTRIE E PUNEVE TE JASHTME DHE DIASPORE			
MINISTRIE E PUNEVE TE JASHTME DHE DIASPORE			
AND ARCHIVING DIVISION DIVIZI ZA ARKIVIM DOKUMENTA T ARHIVIM			
Njesia Org Org. Jediti Org. Unit	10	Nr. Prot Br. Prot Prot. No	1048
Nr. Faqeve Br. Strana No. Pages	02	Data Datum Date	07/03/24
Prishtine / a			

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës**  
**Ministarstvo Inostranih Poslova i Dijaspore - Ministry of Foreign Affairs and Diaspora**

Nr. Ref: 113/2024  
Datë: 06/03/2024

Mbështetur në nenet 10 dhe 11, të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës, nenin 11, të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me Rregulloren Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (Shtojca 1, pika 1, nënpika 1.1), Nenit 12 të Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, paragrafin 1.4 të Nenit 36 të Rregullores MF-Nr.01/2019 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Ministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, nxjerr:

**VENDIM**

- 1. Ndalohet punësimi i anëtarëve të ngushtë të familjes të të punësuarave aktual në Ministrinë për Punë të Jashtme dhe Diasporës.**
- 2. Anëtarët e ngushtë të familjes si në pikën 1 nënkupton radhën e parë dhe të dytë të trashëgimisë sipas ligjit për trashëgiminë dhe ligjit për familjen.**
- 3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.**
- 4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.**

**Arsyetim**

Neni 36 i Rregullores MF-Nr.01/2019 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin autorizon Ministrin të reagoj ndaj rreziqeve të brendshme dhe të jashtme, sipas përcaktimit të Nenit 35 të kësaj rregullore. Ndërsa neni 3 i Ligjit 6/L-021 për Kontrollin e Brendshëm përkufizon efikasitetin si raport ndërmjet burimeve të përdorura dhe rezultateve të arritura në aspektin e sasisë, cilësisë dhe kohës.

Punësimi i personave që kanë lidhje familjare me të punësuarit aktual në MPJD do të rezultonte me detyrimin e MPJD për të shfrytëzuar burime të mëdha njerëzore për të parandaluar konfliktin

potencial të interesit gjatë zhvillimit të aktivitetit të kësaj Ministrie dhe pamundësimin e MPJD për të shfrytëzuar potencialin e plotë të të punësuarve të saj.

Duke marrë parasysh paragrafin 1.5 të nenit 3 të Ligjit 6/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, kontrolli përkufizohet si proces i drejtuar nga menaxhmenti për adresimin e rreziqeve dhe sigurisë së arsyeshme lidhur me arritjen e rezultateve dhe objektivave të Ministrisë. Me këtë bazë, punësimi i personave me lidhje familjare me stafin ekzistues të Ministrisë rrit nivelin e rrezikut në një mënyrë të papranueshme, ndikoi negativisht në efikasitetin dhe besueshmërinë e institucionit, duke e vendosur në kundërshtim me interesin publik. Andaj, duke pasur parasysh atë çka u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Donika Gërvalla-Schwarz**

**Zëvendëskryeministre dhe Ministre e  
Punëve të Jashtme dhe Diasporës**

**Vendimi i'u dërgohet:**

- Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Arkivit të MPJD-së.

